


EMRI/ Ky është personi që u kap me snajper dhe shotgan në portin e Durrësit



18:11 - 8 Dhjetor, 2022



Ditën e enjte u arrestua një person në portin e Durrësit, pasi pas kontrollit të ushtruar nga policia iu gjet një arsenal armësh.

Burime për Abc bëjnë me dije se personi i arrestuar është Selman Lajçi nga Kosova. Gjatë kontrollit të ushtruar në makinën e tij u gjet një snajper, një shotgan dhe një pistoletë.



Menjëherë pas kontrollit është bërë arrestimi i personit.

Njoftimi:

Operacioni nga Policia Kufitare e Portit Durrës, në bashkëpunim me Strukturat Hetimore të DVP Durrës, dhe autoritetet doganore të Portit.

Operacioni i zhvilluar mbi bazën e inteligjencës informative dhe analizës së rrishtut.

Sekuestrohen një armë zjarri snajper, një pistoletë, një armë gjahu dhe municion luftarak.

Vihet në pranga 53 vjeçari, i cili udhëtonte nga Italia në drejtim të Kosovës.

Shërbimet e Policisë Kufitare të Portit Durrës, në vijim të kontrolleve të shtuara për parandalimin dhe goditjen e trafiqeve të paligjshme, bazuar në analizën e rrishtut dhe inteligjencën informative për një shtetas që kishte me vete armë zjarri dhe do të hynte në Shqipëri, organizuan dhe finalizuan, në bashkëpunim me Strukturat Hetimore të DVP Durrës, dhe autoritetet doganore, operacionin policor të koduar “Snajperi”.

Si rezultat i këtij operacioni u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasit S. L., 53 vjeç, banues në Zvicër.

Shërbimet e Policisë kanë kaluar për kontroll në vijën e dytë në hyrje të RSH, 53 vjeçarin së bashku me automjetin e tij tip “Land Rover” dhe gjatë kontrollit, Policia gjeti të fshehura, në brendësi të makinës një armë zjarri pistoletë, një snajper, një armë gjahu, 1367 copë fishekë luftarak dhe 800 copë fishekë për armë gjahu, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për veprime të mëtejshme.

#angazhimpërkushtimsakrificë 🙏🇷🇸
#tëvendosurkundërkrimin ✅
#nëçdoskajtëvendit 🇷🇸
#nëshërbimtëqytetarëve 🙏💛🇷🇸

/Abcnews.al/

*Kryesore Aktualitet Abc Abcnews.AL Armë Emri Porti i Durrësit

Të ngjashme

Si i ndërtuan romakët rrugët, që ekzistojnë ende sot pas mijëra vjetësh?

Pse qentë dhe macet janë anti-stres për njerëzit

Njihuni me ushqimet që ndihmojnë në qarkullimin e gjakut



13:48 - 18 Dhjetor, 2022

Pas dy dekadash, Angelina Jolie jep dorëheqjen nga roli si ambasadore e OKB...

13:44 - 18 Dhjetor, 2022

Tentuan “të hiqnin qafe” biznesmenin Gjoka në Durrës, kush janë dy...

13:39 - 18 Dhjetor, 2022

Drake vendos bastin 1 milion dollarësh për fitoren e Argjentinës

13:26 - 18 Dhjetor, 2022

Princi William shkon vetëm në dasmën e ish të dashurës, Kate Middleton...

13:25 - 18 Dhjetor, 2022

Francesco Totti: Messi dhe Mbappe janë dy “alienë”, por duhet një ekip për të...

13:20 - 18 Dhjetor, 2022

Në kërkim ndërkombëtar për vrasje të mbetur në tentativë, 41-vjeçari...

13:09 - 18 Dhjetor, 2022

Lothar Matthaus: Për mua, Lionel Messi është futbollisti i mijëvjeçarit

13:08 - 18 Dhjetor, 2022

Test, ajo që shihni së pari në foto zbulon çfarë ju frikëson më shumë në...

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

| "Cash" | Privacy | Kushtet e Përdorimit |

Harta e faqes

Aktualitet	Botë	English
Politikë	Ekonomi	Life
Rajon	Emisione	Plus
Sport	Moti	